



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 3 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i njohur KSHPK (në tekstin e mëtejshëm) në seancën e73-të, të mbajtur më 18.08.2022, morri vendimin vijues:

VENDIM

Veprimi ndaj lëndës me numër 12-3083/1 datë 27.08.2011, NDËRPRITET KSHPK vërtetoi se lënda nuk ka elemente për veprimin e saj kompetent në pajtim me Ligjin për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit.

Lënda me numër 12-3083 të vitit 2021 të mbyllet dhe të arkivohet .

Vendimi i KSHPK-së, në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Lënda me numër 12-3083/1 të datës 27.08.2021 është formuar në bazë të denoncimit të paraqitur nga Inspektorati Shtetëror i Mjedisit Jetësorë nëpërmjet ///. Pretendimet e paraqitura në denoncim kanë të bëjnë me dyshime për veprime jo të duhura dhe keqpërdorim të pozitës zyrtare dhe autorizimin nga ana e ish drejtorit të inspektorit, person zyrtarë ///, i cili në periudhën prej vitit /// deri në vitin /// ka angazhuar /// persona me kontratë në vepër, pa i plotësuar kushtet themelore për angazhimin e tyre sipas aktitë të sistematizimit. Angazhimi i personave ishte personal ose nëpërmjet /// edhe pse personat kryenin detyra të rregullta pune në vend të veprave të autorit nga KSHPK-ja kërkohet ta rishqyrtojë këtë rast në përputhje me kompetencat e saj ligjore. Në shtojcë të denoncimit, u dorëzuan edhe prova.

Pas mbikëqyrjes së përmbajtjes së denoncimit dhe provave të paraqitura, KSHPK-ja kërkoi veprime kompetente nga Inspektorati Shtetëror i Punës, i cili pas inspektimit të jashtëzakonshëm pranë Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit Jetësorë, dorëzoi njoftim dhe procesverbal për gjendjen e konstatuar faktike, në bazë të së cilës Inspektorati Shtetëror i Punës ka konstatuar se pretendimet e paraqitura në denoncim janë të pabazuara. Respektivisht, angazhimi i personave, ishte në përputhje me të gjitha rregullat ligjore, nuk janë konstatuar paligjshmëri, parregullsi dhe lëshime, për shkak të së cilës bien poshtë bazat për veprime të mëtutjeshme të KSHPK-së në rastin konkret.



Sipas sa më sipër, KSHPK-ja vendosi si në dispozitë të këtij vendimi.

Dorëzuar deri te:
Parashtruesi i denoncimit

Përgaditi: Mr D. D.
Miratuar: Mr V.G.

KOMISIONI SHTETËRORË
PËR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT
KRYETARE,
Biljana Ivanovska

